

REPUBLIKA E KOSOVËS			
MINISTRIA E SHËNDETËSISË			
DREKTORATI PËR PËRQIPIMIN E SHËNDETËSISË			
Nr. 27.05		2019	
Numër		Data	
01-400-28503			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstva Zdravstva- Ministry of Health

Marrëveshje e mirëkuptimit

mes

Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës

dhe

Komunës së Drenas të Republikës së Kosovës

Palët

Në bazë të *marrëveshjes për financim* të kredisë numër 5442-XK për ta përkrahur Projektin e Shëndetësisë në Kosovë dhe Ligjit Nr. 06/L-133 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, neni 14, pika 5 mbi "Shpenzimet e paparashikuara dhe rezervat", Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministri i Shëndetësisë Uran Ismaili dhe komuna e Drenas, e përfaqësuar nga kryetari i komunës Ramiz Lladrovci, e nënshkruajnë këtë marrëveshje të mirëkuptimit.

Neni 1: Qëllimi

Qëllimi i Marrëveshjes se Mirëkuptimit është transferimi i fondeve të buxhetuara dhe pa alokuara nga Komuna e Drenas te Ministria e Shëndetësisë. Sipas Ligjit të lartpërmendur, këto transferime nuk i nënshtrohen kufizimeve të transfereve të përfshira në nenin 30 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) dhe as nenit 15 të Ligjit Nr. 06 / L - 133 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019.

R 11

Neni 2: Obligimet e Komunës

Obligimi i komunës është të transferojë shumën prej EUR 140,474 nga:

- Programi 'Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale',
- Nën programi 'Shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor',
- Përshkrimi 'Financimi përmes huamarrjes'.

në Ministrinë e Shëndetësisë:

- Përshkrimi 'Financimi përmes huamarrjes'
- Kodi i organizatës 206
- Kodi i programit 113
- Kategoria ekonomike: mallrat dhe shërbimet

Neni 3: Obligimet e Ministrisë së Shëndetësisë

1. Obligimi i Ministrisë së Shëndetësisë është të përdor këto mjete për të zbatuar aktivitetet thelbësore të Projektit të Shëndetësisë Kosovare, sipas Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur për Numrin e Kredisë 5442-XK dhe Ligjin Nr. 06/L-133 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, neni 14, pika 5 mbi "Shpenzimet e paparashikuara dhe rezervat";

2. Me transferimin e fondeve nga komunat në Ministrinë e Shëndetësisë, këto fonde do të jenë në dispozicion për tu shfrytëzuar për aktivitetet e projektit, përfshirë skemën e PPK. Për skemën PPK, fondet do të ju transferohen në komunave pjesëmarrëse në skemën PPK sipas marrëveshjeve të performancës dhe Doracakut operativ të skemës së PPK-së. Transferet e tilla nuk i nënshtrohen kufizimeve të transfereve të përfshira në nenin 30 të LMFPF apo nenit 15 të Ligji Nr. 06/L-133;

3. Lista e komunave që përfitojnë dhe vlerat e tyre përgatiten nga MSh.

Neni 4: Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit vlen për ndarjet buxhetore të vitit 2019.

6 11

Palët nënshkruese

E nënshkruar në Prishtinë, Republika e Kosovës, më datë: 24 / 05 / 2019.

Uran ISMAILI

Ministër i Shëndetësisë



Hamiz LLADROVCI

kryetar i komunës së Drenas